

URDHËR
Nr. 22, datë 9.1.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 1372, DATË 17.12.2025, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SLLOVAKISË”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës; të pikës 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1372, datë 17.12.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Sllovakisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla